

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

KA.nr. 143/11

Data: 20 Maj 2011

Gjyqtari për konfirmim i EULEX-it Gunnar Oyhaugen, në rastin penal kundër;

Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Hime Krasniqi, Selman Gashi, Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj.

Të akuzuar me aktakuzën PPS.nr.102/10, të datës 31 Mars 2011, të parashtruar në gjykatë me datë 07 Prill 2011, për veprën penale të *Krimit të Organizuar* në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 1 të KPPK-së, e lidhur me veprën penale të *Rrëmbimit të Personit* sipas nenit 159, paragrafi 2 të KPPK-së (Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Hime Krasniqi dhe Selman Gashi), *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 3 të KPPK-së (Bedri Krasniqi), dhe *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 3 të KPPK-së (Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Himë Krasniqi, Gazmend Sylaj, Muhamet Bojkaj dhe Ali Bojkaj).

Pas seancës për konfirmimin e aktakuzës, të mbajtur më 20 Maj 2011, në përputhje me nenin 313 dhe 314 të KPPK-së, në prani të Prokurorit Publik, të pandehurve dhe avokatëve tyre mbrojtës, dhe në përputhje me nenin 316, paragrafi 4 të KPPK-së, lëshon si në vijim:

AKTVENDIM

Pranohet aktдорëheqja nga shqyrtimi i aktakuzës dhe provave e parashtruar nga i pandehuri Gazmend Sylaj.

Pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve Muhamet Bojkaj dhe Ali Bojkaj.

Aktakuza e Zyrës së Prokurorisë Speciale PPS.nr.102/10 e datës 31 Mars 2011, **KONFIRMOHET.**

Procedura penale kundër Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj do të ndahet nga rasti i tanishëm dhe do të procedohet me një numër tjetër në shqyrtimin kryesor.

Aktakuza së bashku me të gjitha të dhënat nga dosja e rastit, do ti dërgohet Kryetarit të Trupit Gjykses për shqyrtimin kryesor, menjëherë pasi që ky aktvendim të bëhet final.

Arsyetimi

Me 07 Prill 2011, Zyra e Prokurorisë Speciale e ka parashtruar një aktakuzë PPS.nr.102/10 kundër të pandehurve Bedri Krasniqi, Dervish Idrizaj, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj, Hime Krasniqi, Selman Gashi, Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj për veprën penale të *Rrëmbimit të Personit* sipas nenit 159, paragrafi 2 të KPPK-së dhe *Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve* në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 dhe 3 të KPPK-së. Më lartë janë të dhëna se cilat vepra penale të të pandehurve janë të lidhura me njëra tjetrën.

Pasi që aktakuza është parashtruar gjyqtari për konfirmim, pas vlerësimit, sipas nenit 306, paragrafi 2 të KPPK-së, gjen se aktakuza është përpiluar në përputhje me nenin 305 të KPPK-së.

Gjyqtari për konfirmim e ka caktuar seancën për konfirmim për datën 20 Maj 2011, për të cilën Prokurori Publik, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës ishin ftuar në gjyq. Poashtu pala e dëmtuar ishte ftuar për seancë. Seanca ka qenë e hapur për publikun.

Me 13 Maj 2011 i pandehuri Gazmend Sylaj ka paraqitur heqje dorë nga shqyrtimi i aktakuzës dhe provave sipas nenit 310, paragrafi 1 i KPPK-së.

Gjatë seancës për konfirmim, Prokurori Publik e ka lexuar aktakuzën dhe poashtu i ka propozuar trupit gjykues se procedimet kundër Muhamet Bojkaj, Ali Bojkaj dhe Gazmend Sylaj të ndahen. Pasi që Prokurori Publik e ka lexuar aktakuzën dhe pasi që gjykatësi ka qenë i kënaqur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të pandehurve u është dhënë rasti që të deklarohen fajtor apo të pafajshëm.

Të pandehurit Bedri Krasniqi, Hamdi Krasniqi, Ahmet Neziraj, Ilmi Lufaj dhe Selman Gashi janë deklaruar si të pafajshëm për të gjitha akuzat.

Dervish Idrizaj dhe Hime Krasniqi janë deklaruar si të pafajshëm në lidhje me krimin e organizuar në lidhje me veprën penale të *Rrëmbimit të Personit*. Që të dy janë deklaruar fajtor në lidhje me “*Mbajtjen në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve*”.

Të pandehurit Muhamet Bojkaj dhe Ali Bojkaj janë deklaruar fajtor.

Në parashtrësat e tyre, avokatët mbrojtës e kanë kundërshtuar aktakuzën, duke i propozuar gjykatës se aktakuza ishte hedhur poshtë meqë nuk ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin e shumë bazuar se të pandehurit kanë kryer vepër penale në aktakuzë (KPPK, neni 316 (1) – 4).

Të pandehurit i kanë mbështetur parashtrësat e avokatëve të tyre.

Gjetjet e gjykatës

Gjyqtari nuk gjen ndonjë arsye për ta hedhur poshtë aktakuzën nën nenin 316, paragrafët 1 dhe 2, duke konsideruar se aktet kriminale të përmendura në aktakuzë, janë vepra penale, se nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë kriminale, se parashkrimet nuk kanë skaduar, se aktakuza është parashtruar nga një prokuror i autorizuar, se nuk ka rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale dhe se ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur dyshimin mirë të bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të përmendura në aktakuzë.

Një “dyshim i bazuar” mund të përkufizohet si “*ekzistim i fakteve apo informacionit e cila do ta kënaqte një vrojtues objektiv se personi në fjalë mund ta ketë kryer veprën*”- (ECHR, Fox, Cmbell and Hartley v. Britania e Madhe, 30 Gusht 1990, par.32). Një “dyshim mirë i bazuar” kërkon më shumë siguri se sa dyshimi i bazuar – pa arritur në pragun e një fakti të dëshmuar.

Gjykatësi gjen se, në bazë të dosjes së rastit dhe dëshmive që përmban, ka mjaft prova për mbështetjen e “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me të gjitha akuzat në aktakuzë.

Në bazë të dosjes së rastit, viktima është rrëmbyer nga persona të armatosur në mëngjesin e hershëm të datës 21 Shtator dhe ka qenë i liruar nga rrëmbyesit e tij me 30 Tetor 2010.

Bedri Krasniqi:

Bazat për gjykatësin që të vendos “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Bedri Krasniqin janë – përveç tjerash - edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi- Neni 159 (2) i KPPK-së

- Dëshmia nga ana e viktimës – . Ai nga fotot e ka identifikuar Bedri Krasniqin si personi – derisa ai ka qenë afër maleve – i cili ka arritur në makinën karvan të zezë. Dhe për më tepër se Bedri Krasniqi i ka thënë që familja e tij duhet që të paguaj 30 milion euro për lirin e tij.
- SMS mesazhet e ndryshme dhe kontaktet telefonike nga telefonat e Bedri Krasniqit siç janë të përshkruara në aktakuzë – dhe po ashtu në çfarë mënyre është identifikuar njëri nga telefonat e tij, duke u bazuar në dëshmitaren
- Lëvizjet e Bedri Krasniqit. Kartografia e numrit që i takon të pandehurit Bedri Krasniqi, tregon lëvizjet e tija me datë 21 Shtator 2010.
- Viktima duket se ka përdorur telefonin e Bedri Krasniqit që ta informojë familjen e tij për rrëmbimin e tij.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 3 i KPPK-së;

- rezultat i bastisjes së shtëpisë së Bedri Krasniqit ku ata kanë gjetur një sasi të madhe të armëve dhe municionit.
- ai nuk ka pasur leje valide për armëmbajtje.

Sulm ndaj personave zyrtarë- neni 317, paragrafi 1 i KPPK-së:

- Dëshmia e dëshmitarit

Dervish Idrizaj:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Dervish Idrizajn janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi- Neni 159 i KPPK-së (2):

- Viktima e ka identifikuar Dervish Idrizajn nga fotografitë dhe ka sqaruar se Dervish Idrizaj – kur ka qenë në shtëpinë e pabanuar – e ka incizuar atë dhe ia ka dhënë atij 3 gazeta për ti lexuar në mënyrë që të dëshmojë se viktima është gjallë.
- Dervish Idrizaj – në bazë të hartografisë – ka pasur lëvizje të shpeshta nga Kaçaniku, Vitia, Ferizaji etj., të cilat tregojnë se ai ka shkuar në vendet ku viktima është mbajtur e rrëmbyer.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPPK-së:

- rezultati i bastisjes së shtëpisë së Dervish Idrizajt
- ai nuk ka pasur leje valide për armëmbajtje
- i mbështetur nga fakti se është deklaruar fajtor për këtë akuzë.

Hamdi Krasniqi:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Hamdi Krasniqin janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi – Neni 159 (2) i KPPK-së:

- Viktima e ka identifikuar Hamdi Krasniqin nga fotografitë. Ai ka sqaruar se Hamdi Krasniqi e ka ruajtur atë me një pushkë automatike derisa ai ka qenë në “kasollen e barinjve” në malet e Milishevcit.
- Dëshmitari D1 ka dëshmuar se ai me datën 22 Shtator 2010, në malet e Milishevcit – në një kasolle druri “kasolle barinjsh”, në vendin e quajtur Stani i Bojkave, ka parë dy persona. Njëri nga ata është identifikuar nga ana e dëshmitarit, nga fotot, që të jetë Hamdi Krasniqi.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPPK-së:

- Dëshmia e viktimës për Hamdi Krasniqin si roje me pushkë automatike.
- ai nuk ka patur leje valide për armëmbajtje.

Ahmet Neziraj:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Ahmet Nezirajn janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi- Neni 159 (2) i KPPK-së:

- Viktima ka dëshmuar se ai është 70% i sigurt se Ahmet Neziraj është personi, i cili me një makinë të bardhë, e ka marr atë nga kasollja dhe e ka zbritur atë buzë malit. Ai e ka bërë këtë identifikim në bazë të fotografive që i janë treguar atij.
- Dëshmitari D1 e ka identifikuar Ahmet Nezirajn si vozitësin e makinës së bardhë në malet e Milishevcit me datë 22/09/2010.
- Ahmet Neziraj ka qenë atëherë pronar i Jeep-it të bardhë Toyota.

Ilmi Lufaj:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Ilmi Lufaj janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi – Neni 159 (2) i KPPK-së:

- Viktima e ka identifikuar Ilmi Lufajn të jetë anëtar i grupit të kidnapimit. Megjithatë, viktima nuk ishte në gjendje që të kujtoj se ku dhe kur e ka parë atë.
- Indikacionet se telefoni i Ilmi Lufajt – rreth kohës kur Bedri Krasniqi i ka shkëmbyer mesazhet SMS me familjen e Azem Morinës- ka qenë afër Bedri Krasniqit.
- Telefoni i Ilmi Lufajt, me datë 01 Tetor 2010, i ka patur lëvizjet e njëjta sikurse Bedri Krasniqi.

Himë Krasniqi:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Himë Krasniqin janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi- Neni 159 (2) i KPPK-së:

- Viktima e ka identifikuar Himë Krasniqin të jetë njëri nga personat në shtëpinë e pabanuar. Sipas Azem Morinës, e ka prezantuar veten e tij si Agroni nga Mitrovica.
- Rezultatet nga hetimet në lidhje me telefonat, tregojnë qartë se Himë Krasniqi-në orët e hershme të mëngjesit të 21 Shtatorit 2010 (ditën e kidnapimit)-ka dërguar 7 mesazhe SMS të pandehurit Bedri Krasniqi- dhe ka pranuar nga ai 3 mesazhe SMS.
- Të njëjtin mëngjes ka indikacione të qarta poashtu se Himë Krasniqi ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të pandehurin Selman Gashi.

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPPK-së;

- Kur policia ka bërë bastisje në shtëpinë e Himë Krasniqit me datë 15 Tetor 2010 – ata kanë gjetur një pistoletë Magnum 41 dhe dy fishek për armën e tij. Ai nuk ka patur leje për këtë armë.
- Himë Krasniqi është deklaruar fajtor

Selman Gashi:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Selman Gashin janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Rrëmbim personi – Neni 159 (2) i KPPK-së:

- Në ditën kritike kur viktimja është kidnapuar, Selman Gashi duket se ka dërguar përmes numrit të telefonit të pandehurit Bedri Krasniqi – duke përdorur numrin e telefonit – 16 mesazhe SMS mes kohës prej orës 16: 15 deri në ora 07:26.
- Po të njëjtin mëngjes, ka indikacione se Himë Krasniqi ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me të pandehurin Selman Gashi.
- Po ashtu ka indikacione se Selman Gashi është i involvuar në këtë kidnapim sipas kartografisë së lëvizjeve të tija- në krahasim me lëvizjet e të pandehurve tjerë dhe të viktimës.
- Nga përmbajtja e mesazheve SMS hyrëse dhe dalëse në mes të Selman Gashit dhe Bedri Krasniqit, ditën e rrëmbimit.

Muhamet Bojkaj:

Bazat për gjykatësin për ti vendosur “dyshimin mirë të bazuar” në lidhje me Muhamet Bojkajn janë – përveç tjerash – edhe elementet në vijim:

Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2 i KPPK-së;

- Rezultatet nga bastisja e shtëpisë
- Ai nuk ka pasur leje valide për armëmbajtje
- Është deklaruar fajtor.

Gazmend Sylaj:

Siç është përmendur më lartë – heqja dorë nga shqyrtimi i aktakuzës dhe të provave, e parashtruar nga Gazmend Sylaj, është pranuar nga gjykatësi.

KPPK neni 274 (1) – Krimi i Organizuar:

Gjykatësi gjen se ekziston dyshimi mirë i bazuar se të pandehurit e lartë përmendur kanë vepruar/marrë pjesë në rrëmbim si pjesë e “një grupi të organizuar”.

Në këtë lidhje, gjykata ka vërejtur se si rrëmbimi është organizuar, komunikimi dhe lëvizjet e grupit.

Andaj, duke u bazuar në këto rrethana që janë parashtruar në aktakuzë, gjyqtari për konfirmim gjen se ka prova të mjaftueshme për ta mbështetur **dyshimin mirë të bazuar** se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj me këtë e konfirmon aktakuzën.

Provat e pranueshme – të papranueshme:

Gjykatësi gjen se nuk ka indikacione të qarta se ndonjëra nga dëshmitë e marra gjatë hetimeve janë të papranueshme. Andaj, nuk ka nevojë që të deklarohet ndonjë provë e veçantë si e papranueshme. Nëse avokatët mbrojtës mbështesin faktin se disa nga provat janë të papranueshme, kjo duhet që të konsiderohet dhe të vendoset në lidhje me shqyrtimin kryesor.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktvendimi, sipas nenit 316, paragrafi 4 i KPPK-së.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, KA.nr.143/11 e datës 20 Maj 2011.



Gjyqtar për konfirmim

Gunnar Oyhaugen
Gjyqtar i EULEX-it